



AKK - AZBPKNK - KACA  
Nr. 01-514/09  
Dt. 21.04.09  
PRISHTINË - PRISHTINA



I BESUESHËM

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI MBI SHKËMBIMIN E INFORMATAVE

### Neni 1 - Palët

- 1.1 Ky është Memorandum Mirëkuptimi (Memorandumi) ndërmjet Qendrës së Inteligjencës Financiare (QIF) dhe Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit (Agjencioni).
- 1.2 QIF-i është autoriteti i caktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, e plotësuar, për të pranuar, analizuar dhe shpërndarë informata të ndjeshme financiare lidhur me veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe veprave të ngjashme penale.
- 1.3 Agjencioni vepron sipas Ligjit Nr. 2004/34 të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/26 dhe parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë kundër korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative të korrupsionit publik, eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e punëve në detyrë, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë duke kryer biznes me firmat ku personi zyrtar ose një person në marrëdhënie të afërt me të është i përfshirë.

### Neni 2 - Qëllimi

- 2.1 Qëllimi i këtij Memorandumi është që të shtohet bashkëpunimi dhe koordinimi në lidhje me shkëmbimin e informatave lidhur me zbulimin dhe hetimin e korrupsionit, si dhe zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

### Neni 3 - Fushëveprimi

- 3.1 Ky Memorandum vendos nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet QIF-it dhe Agjencionit dhe i qartëson pritjet dhe synimet e tyre.

- 3.2 Memorandumi vendos procedurat, kushtet dhe kriteret për lehtësimin dhe sigurimin e shkëmbimit të informatave ndërmjet QIF-it dhe Agjencionit.
- 3.3 Dispozitat e Memorandumit lidhur me dispozitat e informatave të kërkuara janë detyruese ndaj secilës Palë në shkallën e arsyeshme të zbatueshme duke i pasur parasysh kufizimet e saj të burimeve.

#### **Neni 4 - Fillimi dhe Mbarimi**

- 4.1 Memorandumi do të jetë në fuqi nga data e nënshkrimit dhe deri në atë kohë që përfundohet ose zëvendësohet nga ndonjë memorandum ose instrument tjetër.
- 4.2 Memorandumi mund të përfundohet nga secila Palë duke njoftuar me shkrim, por mund të plotësohet vetëm me marrëveshjen e të dyja Palëve.
- 4.3 Në rast të përfundimit procedurat, kushtet dhe kriteret lidhur me përdorimin dhe shpërndarjen e informatave të shkëmbyera sipas këtij Memorandumi vazhdojnë të jenë në fuqi dhe janë detyruese për Palët sa i përket informatave të marra nga Palët sipas këtij Memorandumi para përfundimit.

#### **Neni 5 - Zotimet dhe Shkëmbimi i Informatave**

- 5.1 QIF-i zotohet ta shqyrtojë me kujdes ndonjë kërkesë formale që ai i bënë Palës tjetër që të sigurohet se kërkesa është e arsyetuar. QIF-i zotohet t'i përdorë të gjitha materialet dhe informatat e pranuar sipas këtij Memorandumi vetëm për qëllime të inteligjencës dhe aktiviteteve mbikëqyrëse siç autorizohet nga ligji dhe në pajtim me këtë Memorandum. Agjencioni zotohet t'i përdorë të gjitha materialet dhe informatat e pranuar sipas këtij Memorandumi vetëm për qëllime që kanë lidhje me pastrimin e parave të cilat lidhen direkt me kryerjen e veprave korruptive dhe siç autorizohet nga ligji dhe në pajtim me këtë Memorandum.
- 5.2 QIF-i zotohet të:
- (a) Dërgojë kërkesa për informata tek Agjencioni në formatin që tregon autorizimin për kërkesë;
  - (b) Përgjigjet kërkesave me shkrim për informata nga Agjencioni ashtu siç parashihet nga ky Memorandum;
  - (c) Emërojë një pikë kontakti për komunikim ndërmjet Palëve;
  - (d) Mbajë të gjitha informatat e pranuar nga Agjencioni në një bazë të sigurt të të dhënave;
- 5.3 Agjencioni zotohet të:
- (a) Përgjigjet kërkesave formale për informata nga QIF-i për qëllimet e analizave financiare dhe aktiviteteve tjera brenda autoritetit të QIF-it;

- (b) Caktojë një pikë kontakti për komunikim ndërmjet Palëve;
  - (c) Mbajë të gjitha informatat e pranuar nga QIF-i në një bazë të sigurt të të dhënave;
  - (d) Merret me informatat e pranuar nga QIF-i vetëm me pajtim me kriteret specifike ashtu siç janë pajtuar palët.
- 5.4 Secila palë zotohet që, kur është e mundur, e përshtatshme dhe kërkohet nga pala tjetër, të shkëmbejë informata në mënyrë elektronike dhe të koduar.
- 5.5 Kërkesat nga secila Palë do të përmbajnë një numër reference dhe një datë.

#### **Neni 6 - Kushtet**

- 6.1 Të gjitha informatat e ofruara nga njëra palë tek tjetra sipas këtij Memorandumi janë të besueshme dhe duhet të përdoren vetëm për qëllimet e parapara në këtë Memorandum. Nuk mund të kryhet ndonjë përdorim tjetër ose shpërndarje e informatave pa këshillimin paraprak dhe autorizimin me shkrim të Palës që i ofron informatat.

#### **Neni 7 - Interpretimi**

- 7.1 Ky Memorandum mirëkuptimi do të nënshkruhet në dy kopje origjinale në Anglisht dhe dy kopje origjinale në Shqip. Në rast të ndonjë mospërputhje midis tekstit të gjuhës Angleze dhe asaj Shqipe, do të merret parasysh teksti në Anglisht.

Prishtinë, 21 Prill 2009

Qendra e Inteligjencës Financiare

  
**ROBERTO MAGNI**  
Drejtor  
Qendra e Inteligjencës Financiare  


Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit

  
**HASAN PRETENI**  
Drejtor  
Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit  




AKK - AZBPKNK - KACA  
Nr. 01-514/09  
Dt. 21.04.09  
PRISHTINE - PRISHTINA



CONFIDENTIAL

## MEMORANDUM OF UNDERSTANDING ON EXCHANGE OF INFORMATION

### Article 1 - Parties

- 1.1 This is a memorandum of understanding (The Memorandum) between the Financial Intelligence Centre (the FIC) and the Kosovo Anti-Corruption Agency (the Agency).
- 1.2 The FIC is the duly appointed authority under UNMIK Regulation No. 2004/2 as amended to receive, analyze and disseminate sensitive financial information concerning the offences of money laundering and financing of terrorism, and related criminal offences.
- 1.3 The Agency is established in accordance with UNMIK Regulation No. 2005/26 promulgating Law No. 2004/34 and is mandated to undertake measures within the scope of the anti-corruption strategy, particularly in the field of administrative investigation of public corruption; eliminating the causes of corruption; the incompatibility of holding public office and performing profit-making activities for official persons; restrictions regarding the acceptance of gifts in connection with their execution of office; supervision of their assets and those of persons from their domestic relationship; and restrictions regarding contracting entities participating in public tenders conducting business transactions with firms in which the official person or person from his/her domestic relationship is involved.

### Article 2 - Purpose

- 2.1 The purpose of this Memorandum is to enhance cooperation and coordination in respect of information exchange relating inspection activities relating to the detection and investigation of corruption, and the detection and prevention of money laundering and the financing of terrorism.

### Article 3 - Aim and Scope

- 3.1 This Memorandum sets out the nature and level of cooperation and coordination between the FIC and the Agency and clarifies their expectations and intentions.
- 3.2 The Memorandum establishes procedures, conditions and criteria for facilitating and securing the exchange of information between the FIC and the Agency.
- 3.3 The provisions of the Memorandum respecting the provision of requested information are binding on each Party to the extent reasonable and practicable having regard to its resource constraints.

#### **Article 4 - Commencement and Termination**

- 4.1 The Memorandum shall be effective from the date of the signature and until such time that it is terminated or superseded by another memorandum or instrument.
- 4.2 The Memorandum may be terminated by either Party by notice in writing, but may only be amended with the agreement of both Parties.
- 4.3 In the event of termination the procedures, conditions and criteria respecting the use and dissemination of information exchanged under the Agreement continue in force and are binding on the Parties in respect of information obtained by the Parties under the Agreement prior to termination.

#### **Article 5 - Undertakings and Exchange of Information**

- 5.1 The FIC undertakes to give careful consideration to any formal request it makes of another Party to ensure the request is justified. The FIC undertakes to use all materials and information received under this Memorandum for purposes only of intelligence and supervisory activities as authorized by law and consistent with this Memorandum. The Agency undertakes to use all materials and information received under this Memorandum only for purposes having a connection with money laundering related to corruption offences and as authorized by law and consistent with this Memorandum.
- 5.2 The FIC undertakes to:
  - (a) Submit requests for information to the Agency in a format that shows authorization for the request;
  - (b) Respond to written requests for information from the Agency as provided by this Memorandum;
  - (c) Designate a point of contact for communication between the Parties;
  - (d) Maintain all information received from the Agency in a secure database;
- 5.3 The Agency undertakes to:
  - (a) Respond to formal requests for information from the FIC for the purposes of financial analysis and other activities within the authority of the FIC;
  - (b) Designate a point of contact for communication between the Parties;
  - (c) Maintain all information obtained from the FIC in a secure database;
  - (d) Deal with information received from the FIC only in accordance with specific criteria as agreed between the Parties.

5.4 Each Party undertakes that, when it is possible, adaptable and inquired by other Party, to exchange information in electronic and coded form.

5.5. Requests from either Party will contain a reference number and a date.

#### **Article 6 - Conditions**

6.1 All information provided by one Party to the other under this Memorandum is confidential and is to be used only for the purposes provided in this Memorandum. No other use or further dissemination of the information may take place without prior consultation with and written authorization of the Party providing the information.

#### **Article 7 - Interpretation**


7.1 This Memorandum shall be signed in two original copies in English and in two original copies in Albanian. In case of any inconsistency between the English and Albanian text, the English text shall prevail.

Pristine, 21 April 2009

For the Financial Intelligence Centre

  
\_\_\_\_\_  
**ROBERTO MAGNI** Financial Intelligence Centre  
Director  
Financial Intelligence Centre  
DIREKTOR  
KOSOVO

For the Kosovo Anti-Corruption Agency

  
\_\_\_\_\_  
**HASAN PRETENI**  
Director  
Kosovo Anti-Corruption Agency